[Shqiptarja.com]

E hënë 25 Dhjetor 2023 - Përditësimi i fundit 12:22

Kërko

Live Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet më të lexuara në 5 minutat e fundit

VIDEO/ Barcelona gjen Messin e C. Ti njëqari mori topin nga roaz i kuhës dhe befasoi Xavin me një supergol

FOTO/ Djali i Arbanës bën surprizën e papritur e quan Edoardin baba Miraj

Sylvinho e shuka nd Kombëtarë, vërtitë e rëndësisë europiane për Mario

VIDEO/ Sefaxhiu 'gorr' për Vasoilin Karaxi! Kërcënoje gjithë radio kërnët e tij

EMRI/ Merita mahiron me gra në Tiranë, u kaqonte çetitan dhe pas disa kohësh i vdiqën, prangu 42 njerëzit! I shiste në serverët e tij në Dibër

Kronikë

Kamëz/ 33 vjeçari qëllon me armë në drejtim të dy vëllezërve! Shkak u bë xhirimi i gomave të makinës! Sekuestrohet 'Golf-i', autori në kërkim (EMRAT)

Të shtëna me armë zjarri janë raportuar në Kamzë gjatë ditës së sotme. 33 vjeçari Jetmir Koleci ka qëlluar ndaj vëllezërve Ilir dhe Astrit Hallil. Shkak është bërë një sherr banal që ka nisur për xhirimin e gomave të makinës

- 'Pse xhiron gomat e makinës', detaje nga të shtënat me armë në Kamëz! Autori nxori armën, qëlloi dhe mu pas ia mbathi në këmbë
- Del emri i autorit dhe i dy personave që qëlloi

Foto Ilustrueese

Redaksia
24 Dhjetor, 16:40 | Përditësimi: 24 Dhjetor, 22:00

Share

Një i ri në Kamëz ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të dy vëllezërve pasditen sotme dhe më pas është larguar. Report Tv méson se autori është 33 vjeçari Jetmir Koleci i cili ka qëlluar ndaj Ilir dhe Astrit Hallilit në rrethana ende të paqarta.

> *"Më datë 24.12.2023, në rrugën "OSBE", në Kamëz, shtetasi J. K., 33 vjeç, dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasve I. H., 45 vjeç, dhe A. H., 39 vjeç, dhe më pas është larguar", njofton policia.*

Nga të shtënat nuk ka persona të dëmtuar. Siç méson gazetari i Report Tv Sokol Dema, të shtënat janë regjistruar si pasojë e një sherri banal. Pasditen e kësaj të diele, Jetmir Koleci po kalonte me në rrugën "OSBE", ndërsa ka xhiruar gomat. Dy vëllezërit kanë tentuar ta ndalojnë duke i kërkuar sqarime por Koleci ka dalë nga makina me armë në doré duke qëlluar. Vëllezërit Hallili kanë pretenduar se 33 vjeçari ka qëlluar drejt tyre, kurse policia ka dyshime se i riu ka shtënë në ajër për t'i trembur dhe më pas është arratisur në këmbë duke braktisur makinën.

LEXO EDHE:
Edison Ypi: Humba në Bathore

Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar automjeti tip "Golf", i autorit të dyshuar, dhe vijon puna nga shërbimet e Policisë, për kapjen e tij. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të plota të ngjarjes.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:05

'Pse xhiron gomat e makinës', detaje nga të shtënat me armë në Kamëz! Autori nxori armën, qëlloi dhe ma pas ia mbathi në këmbë

Report Tv zbardh detaje nga të shtënat me armë zjarri që janë regjistruar në Kamëz. Autori Jetmir Koleci ka lëvizur rreth 3-4 herë me mjetin e tij në rrugën "OSBE" ku ka ndodhur ngjarja dhe ka xhiruar gomat.

Vëllezërit Ilir dhe Astrit Hallili kanë dalë për t'u sqaruar se përse po xhironte gomat, por Jetmir Koleci pasi ka zbritur nga makina ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar. Sipas dëshmive të vëllezërve Hallili, ai ka qëlluar drejt tyre, por hetuesit kanë dyshime pasi kanë qenë në largësi rreth 1 metër. Hetuesit dyshojnë se Koleci ka qëlluar nga frika në ajër dhe më pas është larguar me shpejtësi në këmbë.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:49

Të shtënat me armë një Kamëz, del emri i autorit dhe i dy personave që qëlloi

Jetmir Koleci është personi që ka qëlluar me armë zjarri këtë pasdite në drejtim të dy personave në Kamëz. Personat që kanë qenë objektiv i të shtënave me armë janë Ilir Hallili dhe Astrit Hallili.

B.K/Shqiptarja.com

Share

B.K/Shqiptarja.com

TAG: të shtëna me armë | Jetmir Koleci | Ilir hallil | Astrit Hallil | kamëz

Komento

Komente

Loni: 25/12/2023 10:55

Ai me mir ti thishte cke qe me shikon cowboy jam pistoleta me e shpejte ne kamez city... Medet sias zones ske cfare flet fare alla tipike 1990 1995 spe me sheh pse kalon ketu pse hecen shpejt me biciklet kjo eshte lagja ime. Ndoshta duhet pak arsimim duhet pak me mugulsi ne arsimimin edhe disiplinimin e personave ne zonat periferike te te gjithe shqiperise.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si ka qënë për ju 2023-shi?

Vit i mirë | Vit i keq | Si të tjerët

Lajme të tjera

EMRI-30 vjeçari hap zjarr drejt berberhanes në Fier, policia i vihet pas! Report Tv sjell pamje nga vendi i ngjarjes
24 Dhjetor, 16:27

Mbi 14 mijë të rinj në arsim profesional, Justiniani programoi sensorin për dyert! 110 biznese partnere me shkollën e mesme në Kamëz

Freard Rista

23 Dhjetor, 11:54

Qëlloi me kallashnikov në ajër pranë banesës së të afërmve të tij, arrestohet 27 vjeçari në Tiranë (EMRI)
19 Dhjetor, 14:22

Tiranë/ Të shtëna me armë në Pezë Helmës, policia gjen thasë me kanabis dhe kallashnikov! Banorët: Autorët qëlluan nga një makinë (FOTO)
14 Dhjetor, 21:43

Pesë grabitje në fundjavë, ekspertët: Dhjetori, muaji problematik! Për festa qytetarët ulin vigilencën, reklamojnë luksin ndërsa rrjetet sociale

Freard Rista

11 Dhjetor, 16:31

Kamëz/ U kthye para 1 javë nga Anglia, 70 vjeçari vret me katër plumba fqinjin për kanalin e ujërave të zeza! Plagos tjetrin! Report Tv sjell pamje (EMRAT-VIDEO)
30 Nëntor, 14:58

'Duart larë se ju vramë', flet për Report Tv pronarja e argjendarisë në Kamëz: Morën 1.5 kg floriri 3 prej tyre u futën brenda, shoferi i priti te BMW

Sokol Dema

Freard Rista

29 Nëntor, 11:11

Grabitet argjendaria në Kamëz, 3 autorët të maskuar marrin 500 gram floriri nën kërcënimin e automatikut! Momenti kur arratisen me 'BMW' (FOTO)
28 Nëntor, 17:47

Peqin/ Kërcet arma në prani të kryebashkiakut Maçi! Hapen kamerat, ka pasur shkëmbim zjarri! Gjenden mbi 20 gëzhoja! Policia në kërkim të personave që u konfliktuan (EMRAT)

Ronaldo Gjoshi

24 Nëntor, 14:02

Sherr mes 3 personave në Vorë! 34 vjeçari i plagosi me thikë vëllain, ushtaraku nxjerr armën e shërbimit dhe e qëllon (EMRAT)
23 Nëntor, 13:02

Shpërthimi me tritol në Kamëz, pranga 58 vjeçarit! Makina që u përdor nga autorët në pronësi të të arrestuarit
19 Nëntor, 12:28

Tritol lokalit në Kamëz! Dy autorë me makinë, vëzhguan me kujdes zonën! Njëri me kapuç hodhi lëndën plasëse! Flet pronari: Nuk kam konflikte (VIDEO)

Sokol Dema

18 Nëntor, 09:31

Lajmi i fundit

Kaosi në Kuvend 'bllokon' ligjet që kërkojnë 84 vota! Ngec 'amnistia', rreth 600 të burgosur 'peng' të sherrit! Asnjë hap para as për Avokatin e Popullit dhe 'Zgjedhoren'
25 Dhjetor, 12:20 nga Danjela Maloku

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje